



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 16.10.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 16.10.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore publike të datës 11.10.2019, për çështjen (JR) nr. 34/2018, datë 13.11.2018, që i përket ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 62, datë 3.8.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Artur Malaj, trupi gjykues vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, si dhe ftoi palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare në seancën e datës 16.10.2019.

Në vijim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në fjalë, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor shkaqet e ankimit, prapësimet dhe provat e paraqitura, Komisioneri Publik parashtron pretendimet e tij përfundimtare në këtë gjykim.

Komisioneri Publik nënvizon se u qëndron të gjitha shkaqeve të parashtruara prej tij në ankimin e datës 26.10.2018, në shtesën e ankimit të datës 4.7.2019, si dhe në parashtrimet dhe qëndrimet e mbajtura gjatë shqyrtimit gjyqësor para Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Komisioneri Publik, në vlerësim të sa u administrua dhe u trajtua gjatë shqyrtimit gjyqësor, në raport me shkaqet e ankimit, si dhe për sa u administrua nga trupi gjykues në seancat e zhvilluara, parashtron konkluzionet përfundimtare, si vijon:

*I. Lidhur me pasurinë: Apartament banimi me sipërfaqe 106.7m², me vendndodhje rruga “***.***” (ish-***.***), Tiranë, me vlerë 5.000.000 lekë, porositur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep./*** kol., datë 31.5.2005, si dhe mbi burimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie*

1. Në kuadër të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, Komisioneri Publik, referuar akteve në dosje dhe deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura/kursime të mjaftueshme të krijuara nga burime të ligjshme për të mbuluar pagesën e shumës 15,130 euro ose 1.874.607 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë, të likuiduar si këst i parë më datë 31.5.2005, ditën e nënshkrimit të kontratës noteriale të sipërmarrjes.
- 1.1 Trupi gjykues, në seancën e datës 6.9.2019, në vijim të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, ku, ndër të tjera, ka kërkuar dhe rivlerësim të të gjithë asetit pasuror, për të vlerësuar nëse subjekti ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 59/1, germa “a”, e ligjit 84/2016, vendosi që të kryejë një analizë të plotë, sa i përket situatës financiare të subjektit të rivlerësimit që nga viti 2003 deri në vitin 2016.
- 1.2 Nga rezultatet e analizës financiare paraprake, deri më datë 31.5.2005, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të të ardhurave të ligjshme në vlerën 1,760,953.02 lekë, për të mbuluar shpenzimet e kryera, përfshirë pagesën e këstit të parë të çmimit të apartamentit në vlerën 15.130 euro, si dhe kursimet e krijuara gjendje në llogari bankare, deri në datën 31.5.2005.
- 1.3 *Sa më sipër*, rezulton se subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në referencë të nenit D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë në kuptim të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

II. Lidhur me kualifikimin si persona të tjerë të lidhur dhe justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë

2. Në kuadër të këtij shkakut ankimi, Komisioneri Publik, në seancën e datës 19.7.2019, është shprehur se në interes të hetimit do ishte cilësimi i shtetasve ***.***, ***.***, si dhe ***.***, si persona të tjerë të lidhur dhe të hetohet mbi burimet e ligjshme të këtyre personave për të krijuar pasuritë e vëna.
- 2.1 Ashtu sikurse u theksua në seancë, arsyeja pse Komisioneri Publik kërkoi cilësimin si persona të lidhur, bazuar në nenin 32 dhe pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, lidhet me dy elemente kryesore: (i) Informacionet e organeve ligjzbatuese mbi pasuritë e fshehura të subjektit të rivlerësimit në emër të personave të tretë; (ii) Rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit mbi këto dy pasuri, pasi kishte rezultuar se shtetasit ***.*** dhe ***.*** kanë shpenzuar dhe investuar në pasuri të paluajtshme gjatë periudhës 2005-2016, vlerën 40.500.000 (dyzet milionë e pesëqind mijë) lekë, pa përfshirë këtu informacionet nga bankat e nivelit të dytë, ndërsa shtetasi ***.*** vetëm në vitin 2013 ka shpenzuar minimalisht për blerjen e pasurive 10.800.000 (dhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë.
- 2.2 Në këto rrethana, Komisioneri Publik, për sa kohë bëhet fjalë për pasuri të fshehur, është shprehur se nevoja për hetim nuk mund të ishte në kushte proporcionaliteti, por e shtrirë mbi të gjithë pasurinë e këtyre personave.
- 2.3 Nga analiza e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbi mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur me subjektin

e rivlerësimit, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë e vëna, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë provuar me dokumentacion të ardhurat e realizuara në justifikim të investimeve të kryera.

2.4 *Si përfundim, sa më sipër*, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën dhe të justifikojë bindshëm krijimin më të ardhura të ligjshme pasurinë e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

III. *Lidhur me shkakun e ankimit, mbi vlerësimin e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni, lidhur me vilën 3-katëshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “***.***”, lagjja “***”, rruga “***”, Vlorë*

3. Për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik rivendos në vëmendje se, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, janë siguruar informacione, të cilat hidhnin dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, konkretisht të një shtëpie 3-katëshe dhe truallit mbi të cilin është ndërtuar kjo vilë.

3.1 Indiciet e konstatuara i përkasin tri burimeve të ndryshme: **(i)** informacionit nga organet ligjzbatuese¹; **(ii)** informacionit nga denoncimet e publikut²; **(iii)** deklarimeve mbi adresën, të bëra ndër vite nga vetë subjekti.

3.2 Komisioneri Publik, gjatë shqyrtimit gjyqësor, theksoi faktin se këto indicie/informacione mbështeten dhe mbi sa ka rezultuar nga hetimi administrativ mbi këtë pasuri. Të dhënat kontradiktore të rezultuara gjatë hetimit administrativ dhe kronologjia e rrethanave dhe fakteve mbi këtë aset, tregojnë lidhje të forta të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, ashtu sikurse janë trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit, hedhin dyshime se subjekti është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij.

3.3 *Sa më sipër*, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij, duke mos arritur të provojë të kundërtën dhe, bazuar në nenin D/5 të aneksit të Kushtetutës, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, mbi të duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit.

IV. *Lidhur me shkaqet e trajtuara në shtesën e ankimit, mbi gjetjet e paraqitura nga ONM-ja, mbi rezultatet e analizës financiare dhe mbi denoncimet e paraqitura*

4. Komisioneri Publik, mbi këtë shkak ankimi, ashtu sikurse deklaroi dhe në seancën e datës 3.10.2019, çmon se në analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, janë analizuar të gjitha të dhënat e akteve të administruara, si dhe kjo analizë pasqyron në mënyrë të drejtë situatën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për vitet objekt kontrolli.

4.1 Pretendimet e subjektit mbi të ardhurat e realizuara nga fitimi i aktivitetit noterial të bashkëshortes, nuk mbështeten nga të dhënat e akteve në dosje, të cilat faktojnë të kundërtën e interpretimeve të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtimet e paraqitura në

¹ Shkresa nr. *** prot., DSIK, datë ***.5.2018.

² Denoncimet në dosjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, administruar në fashikullin e Komisionit.

datën 3.10.2019. Komisioneri Publik, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, u shpreh mbi dakordësinë për sa është pasqyruar dhe argumentuar në zërat përkatës të analizës financiare lidhur me këto të ardhura.

4.2 Lidhur me informacionet/denoncimet, bashkëlidhur ankimit/shtesës së ankimit, vlerësojmë se do të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përmbushje të nenit Ç, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

V. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik çmon se:

- Në interpretim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 33, pikës 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;

- Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7 të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

Ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, magjistrat/gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

KOMISIONERI PUBLIK
Darjel SINA